



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.221, datë 29.06.2021

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS
SË KANDIDATIT QË KA KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË
KUALIFIKUAR ME VENDIMIN NR. 220, DATË 29.06.2021,
TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "a", të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2 dhe 190, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në pikat 2-7 të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Vendimin nr. 171, datë 27.09.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për miratimin e Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve", e ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë "Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", si dhe me propozimin sipas relacionit të propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit që ka kandiduar për pozicion drejtuesi, kualifikuar me Vendimin nr. 220, datë 29.06.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

- **Durim Bedini** kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

SEKSI I KESHILLIT

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

NURIHAN SEITI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR

ESMERALDA KESHI

ANËTAR

MOISI DUDA

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

TARTAR BAZAJ